[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

MBI DISPONIMIN E MAKINERIVE

Operatori ekonomik: _____

Deklaroj se zotëroj mjetet pajisjet teknikedhe asete të tjera fizike për të realizuar kontratën me objekt: _____

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
1				
2				
3				
4				
5				

Dhe

Me qera					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes së qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës së qerasë (Data e fillimit dhe mbarimit)
1					
2					
3					
4					
5					
6					

- shto/fshi rreshta të tjerë nëse nevojitet.

Ne autorizojmë autoritetin përgjigjës të verifikojë informacionin e dhëne në këtë tabelë.

PERSONI I KONTAKTIT (për këtë ofertë)

Emri:

Adresa:

Nr. Telefonit:

Faks:

E-mail:

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 14

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik)

DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROCES NË KUADËR TË RINDËRTIMIT³

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Përgjegjës _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj se kam në proces dhe/ose jam shpallur fitues për kontratat e në kuadër të rindërtimit, si mëposhte:

Nr.	Autoriteti Përgjegjës	Objekti i procedurës se prokurimi/kontratës në kuadër të rindërtimit ⁴	Vlera e shpallur fituese

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shënim: Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

³Vetëdeklarim nga operatori ekonomik që nuk është fitues dhe/apo ka në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë/nëkontraktorë, një investim/investime, sipas një kontrate apo kontratave të lidhura a në proces për t'u lidhur, në kuadër të rindërtimit, i cili në çastin e hapjes së ofertave nuk i ka përfunduar punimet fizike, në masën 40 % të vëllimeve të përgjithshme të punës.

Shërimi: Kjo deklaratë nuk plotësohet nga operatori/et pjesëmarrës për procedura me objekt kontrate/marrëveshjet kuadër për banesat individuale.

Shtojca 15

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

DEKLARATË MBI NDËRTIMET CIVILE DHE INDUSTRIALE⁵

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Përgjegjës _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Operatori ekonomik _____, nuk është subjekt i ndërtimeve civile (godina banimi ose ndërtesa të tjera shtetërore) dhe industriale të projektuara, ndërtuara, të mbikqyrura dhe/ose të kolaudura, të dëmtura nga ngjarja e fatkeqësisë natyrore, të përcaktuara në nenin 42/5/ë të Aktit normative nr.9/2019.

Personi/at në cilësinë e aksionarit, oraktu, administratorit dhe ose anëtarët e një organi administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësi i tij aksionar ose ortak duhet të deklarojnë se nuk kanë pasur kompetenca vendimarrëse në një shoqëri, ku ndërtimet civile civile (godina banimi ose ndërtesa të tjera shtetërore) dhe industriale të projektuara, të ndërtuara, të mbikqyrura dhe/ose të kolaudura, nga kjo e fundit janë të dëmtuara nga ngjarja e fatkeqësisë natyrore, të përcaktuara në nenin 42/5/ë të Aktit normative nr.9/2019.

Në çdo rast, autoriteti përgjegjës ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomiksi më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shënim: Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

⁵Akti normativ nr.9, date 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” neni 42, pika 5 shkronja ë).

Shtojca 16

[*Shtojce per tu plotesuar nga Autoriteti Përgjegjës*]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 42 të Aktit Normativ.
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet përgjegjëse.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rasti se kemi grupe operatorësh ekonomikë, seicili prej operatorëve duhet të dorëzojë vetdeklarimet, sipas kësaj Shtojce.

Në çdo rast, autoriteti përgjegjës ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim grup operatorësh ekonomikë, duhet te dorezohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar, sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore sipas përcaktimit në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; (**Kjo shtojce do paraqitet ne fazen e II**)
- b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 4; ;
- c. Sigurim ofertes sipas Shtojcës 5; (**Kjo shtojce do paraqitet ne fazen e II**)
- ç. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;
- d. Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 8;
- dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 11;
- e. Formular vlerësimi sipas Shtojcës 12;
- f. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve/makinerve sipas Shtojcës 13;
- g. Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo ne proces në kuadër të rindërtimit, sipas Shtojcës 14;
- gj. Deklaratë mbi ndërtimet civile dhe industriale sipas aktit normative sipas Shtojcës 15;
- h. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri

2. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti Ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas Kriteve të përgjithshme të Pranim/Kualifikimit.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1- Vlera mesatare e xhiros realizuar nga operatori ekonomik gjatë tre viteve të fundit kur ky informacion është i mundur, ku mesatarja e të tre viteve duhet të jetë jo më e vogël se 45 % e vlerës së fondit limit të vënë në dispozicion.

Në plotësimin e kësaj pike operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim nga Dega e Tatim-Taksave për xhiron gjatë tre viteve të fundit kur ky informacion është i mundur si dhe
- b) Kopje të certifikuara të bilanceve për tre vitet e fundit kur ky informacion është i mundur

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme

- a) punë të ngjashme **për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë **pesë viteve të fundit**, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, **ku vlera monetare totale e punëve të kryera**, e marrë së bashku gjatë **pesë viteve të fundit**, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.
Pika /a plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në

kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të permbushë këtë kusht. Kurse pika /b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve, shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar;
 - Faturat tatimore,
 - Aktin e kolaudimit;

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- vertetim leshuar nga subjekti privat shoqëruar me:
- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- faturat tatimore
- Akt kolaudimi objekti;

Shënim: *Vertetimi duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- d) Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontraten e bashkimit të operatoreve dhe prokurën e posaçme të deklaruara në fazën e tenderimit;

/e) Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

- 2.3.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhenies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi". Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

- **NP – 1 C** (Punime gërmimi në tokë)
- **NP – 2 F** (Ndërtime civile dhe industriale)-
- **NP – 3B** (Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile dhe industriale, veshje fasada)
- **NP – 7B** (Ujësjellës, kanalizime, vepra kulimi e vaditje)
- **NP – 11B** (Ndërtime për N/Stacionet, kabinat e transformatoreve linja TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë)

- NP-12 E(Punime te inxhinierise se mjedisit)

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

- **NS – 1A**(Punime për prishje në ndërtimeve)
- **NS - 2D**(Impjante hidro – sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre)
- **NS - 3C**(Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)
- **NS - 4F**(Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to . Rifiniturë me materiale druri, plastik , metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese)
- NS-8 C (Ndertime parafabrikate,beton arme,struktura metalike dhe druri)
- NS-9 C (Punime te strukturore speciale)
- NS-10 A (Shtresa dhe mbistruktura speciale)
- NS-12 C (Impiante teknologjike termike dhe te kondisionimit)
- NS-13 C (impiante dhe linja telefonike dhe telekomunikacioni)
- NS-14 C (impiantete brendeshme ,elektrike,telefoni,radiotelefoni,tv)
- NS-16 A (ndertimi i impianteve te ujit te pishem dhe pastrimit te tij)
- NS-18 A(Punime topogjeodezike)
- NS-19 A (sisteme kunder zhurmes per infrastrukturen)

*Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjise, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). **Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.***

2.3.3 - Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht **200 persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për periudhen 3 muajt e fundit, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, **sipas shtojcës përkatëse. Ndërsa operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:**

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhen 3 muajt e fundit.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën 3 muajt e fundit.

SHPJEGIM ----Per llogaritjen e numrit te punetoreve eshte arsyetuar si me poshte:

Sipas Vendimit i Këshillit të Ministrave nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”per cdo ze te preventivit jane mare oret e punes per njesi. Duke i shumezuar me volumet per cdo ze, kane dale oret e punes te nevojshme per realizimin e ketij zeri. Nevoja per ore pune eshte perkthyer ne dite pune dhe duke i mare ne konsiderate oret e punes qe jane percaktuar ne grafikun e punimeve, ka dale numri I nevojshem I punetoreve per cdo ze.

Duke pare te gjithë zerat e preventivit, natyren e punimeve dhe kerkesave minimale te punonjesve te kualifikuar,punimet jane grupuar ne 4 kategori te kryesore, 1. PUNIME

GERMIMI, 2. PUNIME BETONI, 3. PUNIME SHITRESASH, 4. PUNIME ELEKTRIKE. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 200 persona duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t'i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë**, si më poshtë:

Min 1 (nje) Inxhinier Ndertimi (Profili Strukturist)

Min 1 (nje) Inxhinier Ndertimi (Profili Ndërtime Hidroteknike, Rrugë Ura)

Min 1(nje) Inxhinier Topograf/ Gjeodet

Min 1 (nje) Inxhinier Elektronik, Informatik, Telekomunikacioni, IT.

Min 1 (nje) Inxhinier Mjedisi (e pajisur me certifikatë mbi ndikimin në mjedis të lëshuar nga Ministria e Mjedisit.)

Min 1(nje) Inxhinier Mekanik (Profili inxhinier mekanik teknolog)

Min 1(nje) Inxhinier Elektrik

Min 1(nje) Inxhinier Gjeolog

Min 1 (nje) Arkitekt

Për secilin pjestar të stafit teknik të mesiperm duhet të paraqese, Kontrate pune e vlefshme, diplome, Libreze pune dhe CV (Drejtuesit teknik të jone të siguruar sipas legjislacionit në fuqi për periudhën 3 muajt e fundit.

2.3.5 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

Min 1 (nje) Inxhinier Ndertimi (Profili Infrestruktur)

Min 1 (nje) Inxhinier Pyjesh/ Agromjedis

Min 1(nje) Inxhinier Elektrik

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

Për secilin pjestar të stafit teknik të mesiperm duhet të paraqese, Kontrate pune e vlefshme, diplome, Libreze pune dhe CV (Stafi mbështetës të jone të siguruar sipas legjislacionit në fuqi për periudhën 3 muajt e fundit.

SHPJEGIM----- Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si i stafit ndimes, është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për

ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet disponoje punonjës të specializuar/ kualifikuar si më poshtë:

Min 1 (një) punonjes i pajisur i çertifikuar “**Ekspert per ndihmen e pare dhe nderhyrjen ndaj emergjencave**”, e cila te jete e leshuar nga shoqeri te akredituara ose nga organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.

Min 1 (një) punonjës që disponon çertifikatën si “**Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë**” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327, datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e e rregullores ”Për sigurine në kantier”.

- Te pakten njeri prej drejtuesve teknik te kete certificate per “**Auditues Energjie** “.

-Operatori ekonomik te kete **Liçense per Mbrojtjen nga Zjarri** te leshuar nga QKL. Kodi **1.2.A.** si dhe te kete ne stafin e tij min 1 (nje) **specialist Ekspert Zjarrfikes** ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin, ne mbeshtetje te pikes 4 te nenit 49 te Ligjit Nr. 152/2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin", te figurojne ne listepagesat e shoqerise. Detyrimisht te paraqitet kontrate pune dhe certifikata perkatese e dhene nga Drejtoria e MZSH dhe i pajisur me Liçense per Mbrojtjen nga Zjarri te leshuar nga QKL. Kodi 1.2.A.

-Operatori ekonomik për të siguruar shërbimin mjekësor në shoqëri duhet të ketë të punësuar min **një mjek** të përgjithshëm ose të ketë të kontraktuar nga jashtë këtë shërbim. Në rastin kur mjeku është i punësuar në shoqëri, duhet të paraqesë një kontratë pune të vlefshme, licensë për ushtrimin individual të profesionit, diplomë. Në rastin kur mjeku është kontraktuar nga jashtë, do të paraqitet kontrata për këtë shërbim, licensa përkatëse ,si dhe faturen e ketij sherbimi .personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”. ndryshuar me vendimin nr. 632, datë 15.7.2015).Në rast se mjeku është i punësuar në shoqëri, të figurojë në listepagesat e shoqërisë.

Për përmbushjen e këtyre kriteve, operatori duhet te paraqesë diplomë/ Çertifikatat e cituara më sipër dhe kontrate pune dhe te figurojne ne listepagesat e shoqerise.

SHPJEGIM---*Kërkesa e mësipërme është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.*

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënëz zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga zjari apo çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

2.3.7 Kandidati ofertues duhet të përcaktoje me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve (*inxhinier ndertimi me experience pune mbi 5-vite*) në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm: diplome, libere pune dhe kontrate pune.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar staf teknik të pajisur me dëshmi profesionale të leshuara nga shoqëria të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare të akredituara të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- Elektricitist min 6 (gjashtë)
- Hidraulik min 5 (pese)
- Karpentiere min 4 (kater)
- Hekurkthyes min 4 (kater)
- Mekanik min 2 (dy)
- Saldator min 2 (dy)
- Murator min 5 (pese)
- Pllakashtrues min 5 (pese)
- Hidroizolues min 3 (tre)
- Bojaxhi min 6 (gjashtë)
- Punëtor/Specialist ndertimi min 4 (kater)
- Shofera min 4 (kater)
- Eskavatorista min 3 (tre)

-Për punonjësit të paraqitët Kontrate pune e vlefshme, certifikatat përkatëse dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë. *për periudhën 3-muajt e fundit.*

1. Për shoferat, eskavatoristet, automakinistet të paraqitët dëshmia e aftësisë profesionale, për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë të leshuar nga DPSHTRR dhe në rastin kur makineritë dhe pajisjet disponohen me qera.
2. Në rastin kur mjetet dhe pajisjet për të cilat janë të nevojshëm punonjësit e kualifikuar shofer/manovrator do të merren me qera operatori nuk është e nevojshme të disponoj kontratën e punës dhe formularët E-sig për këto punonjës.

-Operatori ekonomik duhet të ketë min 2 (dy) Teknik Ndertimi të cilët duhet të jenë të pasjitur me Kontrate pune të rregullt, diplome përkatëse si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë. *për periudhën 3-muajt e fundit.*

- Operatori ekonomik të ketë në stafin e tij min 5 (pese) specialist të certifikuar për "Punime në lartësi", të figurojnë në listepagesat e shoqërisë për periudhën Maj – Korrik 2022. Detyrimisht të paraqitët kontrate pune dhe certifikata përkatëse e dhënë nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj .

SHPJEGIM -----Kërkesa e mësipërme është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.

162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Vendosja e ketyre kriterëve për fuqinë punëtore është bere ne perputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit te punimeve sipas grafikut te punimeve.

2.3.9.Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	në pronësi ose me qira	Copë min 3
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton	në pronësi ose me qira	Copë min 3
3	Kamioncine deri ne 3.5 ton	në pronësi ose me qira	Copë min 3
4	Kamion me Vincme kapacitet mbajtës 5-7 ton	në pronësi ose me qira	Copë min 1
5	Trajler per transport mjetetsh	në pronësi ose me qira	Copë min 1
6	Fadrome me Goma	në pronësi ose me qira	Copë min 1
7	Eskavator me goma	në pronësi ose me qira	Copë min 1
8	Eskavator me zinxhirë	në pronësi ose me qira	Copë min 3
9	Minieskavator me zinxhir	në pronësi ose me qira	Copë min 2
10	Mini fadrome	në pronësi ose me qira	Cope min 1
11	Autobot uji	në pronësi ose me qira	Copë min 2
12	Motobetoniere kantieri	në pronësi ose me qira	Cope min 5
13	Autobeniere	në pronësi ose me qira	Copë min 4
14	Autopompe betoni	në pronësi ose me qira	Copë min 2
15	Vibrator betoni	në pronësi ose me qira	Copë min 4
16	Pompa Suvatimi	në pronësi ose me qira	Copë min 3
17	Tranxhe per prerjen e kthimin e hekurit	në pronësi ose me qira	Cope min 1
18	Armatura druri (betoforma) 500 m2	në pronësi ose me qira	min 500 m2
19	Vinc Kull me kapacitet jo me pak se 3 ton	në pronësi ose me qira	Cope min 1
20	Vinc karel (portativ) i levizshem me kapacitet 0.3 ÷0.5 ton:	në pronësi ose me qira	Cope min 3
21	Kamion me kosh per punime ne lartesi,	në pronësi ose me qira	Cope min 1
22	Impiant Betoni auomatik me mikser (e pajisur me leje mjedisore kodit III.1.B)	në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi	Cope min 1
23	Nyje inerte (e pajisur me leje mjedisore kodit III.1.B)	në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi	Cope min 1
24	Depozitë Uji (30.000 Litra)	në pronësi ose me qira	Cope min 1
25	Pompa Uji	në pronësi ose me qira	Copë min 2
26	Rul vibrus minimumi 8 ton	në pronësi ose me qira	Copë min 2
27	Pajisje niveluese per nivelim shtresash	në pronësi ose me qira	Copë min 1
28	Gjenerator	në pronësi ose me qira	Copë min 2
29	Elektrosaldatrice	në pronësi ose me qira	Copë min 2
30	Autobot per largimin e ujrave te zeza	në pronësi ose me qira	Copë min 1
31	Konteiner stacioner	në pronësi ose me qira	Copë min 1

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 100 (njqind) copë
- Jelekë minimumi 100 (njqind) copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme minimumi 10 (dhjetë) copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 5 (pesë) copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 (pesë) copë

- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 20 (Njëzetë) copë
- Karroca dore minimumi 10 (dhjetë) copë

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronësinë e mjetit:- certifikatën e pronësisë; -leja e qarkullimit; - certifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; leja e transportit që leshohet nga njesia vendore dhe fotot perkatese ku të duket qarte targa dhe shërbimi i tij;

Ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesipërme, duhet të paraqitet edhe kontrata noteriale e qirase, e cila duhet të përfshijë emërtimin e objektit perkates dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.

Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore perkatese, fotot ku të duket qarte dhe shërbimi i tij, ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesipërme, duhet të paraqitet edhe kontrata noteriale e qirase, e cila duhet të përfshijë emërtimin e objektit perkates dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve

Për impiantin e betonit dhe të nyjeve inerte duhet të paraqiten kontrata e blerjes apo zhdoganimit, fotot ose fatura tatimore perkatese, leja mjedisore leshuar nga QKL. Nëse është marre me qira/furnizim krahas dokumentacionit të mesipërme, duhet të paraqitet edhe kontrata noteriale e qirase/furnizimit. Operatori ekonomik për fabriken e betonit, nyjen e inerteve dhe mund të paraqesë edhe kontrata të vlefshme furnizimi me operatore ekonomike. Në këtë rast duhet të paraqesë kontratën e furnizimit dhe dokumentacionin që verteton ekzistencën dhe pronësinë e impiantit.

Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera. Për këtë të paraqitet një deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese se makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë deklaruar në një procedurë tjetër tenderimi në të cilën nuk është shpallur ende fituesi.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

SHPJEGIM --Kërkesat e mesipërme janë vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" dhe Nenit 39, pika 6, germa "d" të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës.

2.3.10 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

a-Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë :

ISO 9001:2015 Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë

ISO 14001:2015 Sistemet e Menaxhimit Mjedisor

OHSAS 18001-2007 ose ISO 45001 Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë

Të gjitha çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

b-Operatori ekonomik të disponojë Licencë QKL III.2.B, Grumbullim, Transportim , Ruajtje , e mbetjeve Inerte e Urbane.

c-Operatori ekonomik të disponojë Leje mjedisore Kodi III.1.B ,Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme të lëshuar nga qendra kombëtare e Licensimit për veprimtari që kanë ndikim ndaj mjedisit

d- Operatori ekonomik të disponojë Licencë QKL III.2.B Grumbullim dhe transportim i ujrave të ndotura urbane, llumrave septike dhe ujrave të zeza.

SHPJEGIM --- Këto licensa kanë emërtim kategorie të përbashkët “Veprimtari të tjera profesionale lidhur me ndikimin në mjedis”.Në nenin 3 të Ligjit Nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” janë dhënë përkufizimet për llojet e mbetjeve.Konkretisht bazuar në objektin e prokurimit “Ndërtimi” dhe në zërat e preventivit të publikuar kërkohet që operatori të jetë pajisur me Leje dhe Licensate Kategorisë III.2.B,III.1.B me qëllimin që të siguroj konform legjislacionit shqiptar për menaxhimin e mbetjeve të integruara, largimin e materialeve që rezultojnë nga ndërtimi, dherave nga kantieri i ndërtimit

2.3.10-Grafiku i punimeve.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 17

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti përgjegjës)

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike të punëve objekt prokurimi: **“Ndërtimi i Institutit të Policisë Shkencore”**

Skicimet, Planimetritë e Objektit etj: **bashkëlidhur DST**

Specifikimet Teknike të Materialeve: **bashkëlidhur DST**

Grafiku i Punimeve: **bashkëlidhur DST**

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: **bashkëlidhur DST**

Shtojca 18

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti përgjegjës)

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

- **Bashkëlidhur DST**

Shtojca 19

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Përgjegjës*]

GRAFIKU I ZBATIMIT TË PUNIMEVE

Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër do të jetë 24 muaj. Kohëzgjatja e kontratës/kontratave do të jetë deri në 18 (tetëmbëdhjetë) muaj nga momenti i lidhjes së minikontratës

Shtojca 20

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Përgjegjës]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR⁶

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit përgjegjës]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Aktin Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u skualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Përgjegjës ka shkelur Aktin Normativ gjatë procedurës së prokurimit publik për rindërtimin, atëherë keni të drejtë të ankoheni siç parashikohet në nenin 42 të Aktit Normativ nr.9/2019.

Me respekt
< **Emri** >

⁶ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Dokumenta Standarde të Tenderit

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NUIS-it*
Vlera _____
(me numra dhe fjalë)
Etj.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikët mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NUIS-it*
2. _____
Emri i plotë i shoqërisë numri i NUIS-it
Etj.

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri, Nipti dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur nga ana juaj dhe e vlerësuar me _____ pikë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit përgjegjës dhe referenca e kontaktit*] sigurimine kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*].

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit përgjegjës]

Shtojca 22

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Përgjegjës në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____

2. _____

3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Shtojca 23

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotësuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afatii realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Përgjegjës dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Përgjegjës se Punët janë mbaruar.

Dokumenta Standarde të Tenderit

- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Përgjegjës lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontrates. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti KonPërgjegjëstraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për autoritetin përgjegjës.
- 2.15 “Autoritet Përgjegjës” do të thotë Autoriteti Përgjegjës që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluar, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndertimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Përgjegjës i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të perkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikrat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Përgjegjës mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupuara. Veprimet e korrupuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë autoritetin përgjegjës të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Përgjegjës.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Përgjegjës duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t'i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Përgjegjës deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtun ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Përgjegjës të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Përgjegjës.
- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Përgjegjës zhvishjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.

- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Përgjegjës në lidhje me ndonjë shkëlqje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Përgjegjës të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Përgjegjës.
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin përgjigjës siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit te punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e AutoritetitPërgjegjës

